



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 118

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 11 korrik 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 42, datë 29.5.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 206, datë 29.3.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2023-1038 (123), datë 18.4.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Interpretimin e nenit 66 të Kodit Penal në raport me nenin 3 të këtij Kodi dhe me praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me zbatimin e sigurisë juridike për rastin konkret.....	14311
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 43, datë 4.6.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-3346, datë 26.7.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjyqimit.....	14322
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 10352/1, datë 8.7.2024	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare	14329
Urdhër i Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 116, datë 8.7.2024	Për delegim kompetencash.....	14329
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 36, datë 3.7.2024	Për miratimin e një ndryshimi në rregulloren “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISAR)”....	14330
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 492/9, datë 5.7.2024	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim i rrugës ‘Andrea Stathi’, Bashkia Korçë”.....	14330



VENDIM
Nr. 42, datë 29.5.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 29.5.2024
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të
dokumenteve çështjen nr. 19 (L) 2023 të Regjistrit
Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Lumturi Varfi

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e
Përgjithshme, përfaqësuar nga prokuror Isa Jata, me
autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 206, datë
29.3.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2023-
1038 (123), datë 18.4.2023, të Kolegjit Penal të
Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me
Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Interpretimi i nenit 66 të Kodit Penal në raport
me nenin 3 të këtij Kodi dhe me praktikën
unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës
Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me
zbatimin e sigurisë juridike për rastin konkret.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, 15, 21, 42, 43, 124,
131, 133 dhe 134, të Kushtetutës së Republikës së
Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 2 i Konventës
Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet
27, 50, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000,
“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës
Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të
ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në
shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuases, që ka
kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim
të subjektit të interesuar, Prokurorisë së

Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si
dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Lumturi Varfi (*kërkuesja*) është
motra e shtetasit A.V. (*viktima*). Në mbremjen e
datës 10.11.1995, në qytetin e Vlorës, poshtë pallatit
ku banonte, ku ndodhej edhe lokali i babait, viktima
është dhunuar fizikisht nga disa persona, të cilët më
pas e kanë futur me forcë në një autoveturë dhe janë
larguar në drejtim të panjohur. Policia është njoftuar
menjëherë për këtë ngjarje dhe, po ashtu, kërkuesja
ka bërë edhe kallëzim penal. Mbi referimin e oficerit
të Policisë Gjyqësore, Prokuroria pranë Gjykatës së
Rrethit Gjyqësor Vlorë (*Prokuroria Vlorë*), ka
regjistruar procedimin penal për veprën penale
“Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, të
parashikuar nga neni 109 i Kodit Penal (KP). Në
kuadër të hetimit, më datë 11.11.1995 është bërë
këqyrja e vendit të ngjarjes dhe janë marrë disa prova
materiale, ndërsa janë pyetur edhe tre banorë të
zonës që kanë qenë pranë vendit të ngjarjes. Më datë
13.11.1995 janë marrë deklaratimet e babait të
viktimitës dhe është këqyruar libri policor i marrjes së
denoncimeve, duke u evidentuar se në denoncimet
e datës 7.11.1995 është shënuar edhe informacioni
se shtetasit L.Xh. i është vjedhur automjeti në afërsi
të lokalit të babait të viktimitës. Po në këtë datë janë
marrë deklaratime edhe nga bashkëshortja e shtetasit
L.Xh. Ky i fundit, më datë 14.11.1995, është shpallur
në kërkim policor në kategorinë e personave
“shumë të kërkuar”, si autori kryesor i dyshuar për
veprën penale.

2. Në vijim, më datë 6.12.1995, një banor i zonës,
rastësisht, në një pyll në afërsi të fshatit Darëzezë,
Fier, ka gjetur të groposur viktimen A.V. Për këtë
ngjarje Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit
Gjyqësor Fier (*Prokuroria Fier*) ka regjistruar
procedimin penal për veprën penale “Vrasja me
dashje”, të parashikuar nga neni 76 i KP-së. Në
kuadër të hetimit të kësaj ngjarjeje, më datë
6.12.1995 janë marrë deklaratime nga personi që ka
gjetur viktimen të groposur, ndërsa më datë
7.12.1995 janë marrë deklaratime nga babai i autorit të
dyshuar L.Xh. Po ashtu, është urdhëruar kryerja e
ekspertimit mjekoligjor të viktimitës dhe, më pas,



edhe një ekspertim balistik i predhës së gjetur në trupin e tij. Nga ekspertimi mjekoligjor ka rezultuar se viktimë është qëlluar dy herë me armë zjarri, në kokë dhe në gjoks, dhe dëmtimet e shkaktuara i kishin sjellë vdekjen. Krahas kësaj, në trupin e viktimës janë konstatuar edhe dëmtime të tjera të shkaktuara me mjete të forta përpara vdekjes, e cila duhej të kishte ndodhur mbi 20 ditë përpara, por jo më shumë se 30 ditë. Kurse sipas ekspertimit balistik, predha e gjetur në trupin e viktimës është qitur nga një armë zjarri pistoletë e kalibrit 7,65 mm.

3. Më datë 27.12.1995 aktet e procedimit penal të regjistruar pranë saj, Prokuroria Vlorë ia ka kaluar për kompetencë Prokurorisë Fier, për shkakun se dy procedimet penale kishin lidhje mes tyre dhe se vepra penale e vrasjes që po hetonte kjo e fundit ishte më e rëndë. Më datë 25.1.1996 Prokuroria Fier ka vendosur bashkimin në një të vetëm të dy procedimeve penale. Në vijim, në datat 12 e 20 shkurt dhe 11 e 22 prill 1996 janë ripyetur babai dhe bashkëshortja e autorit të dyshuar L.Xh., përveçse janë pyetur edhe nëna dhe vëllai i tij, të cilët kanë deklaruar se nuk kishin dijeni për vendndodhjen e L.Xh. prej nëntorit të vitit 1995.

4. Hetimi ka mbetur në këtë gjendje deri kur, pas një ankese të babait të viktimës, me urdhrin nr. 10, datë 18.7.1996, zëvendësprokurori i përgjithshëm ka urdhëruar Prokurorinë Fier të kryente një sërë veprimesh hetimore të vlerësuara si të nevojshme për zbardhjen e ngjarjes dhe identifikimin e autorëve të veprës penale. Në datat 26 korrik dhe 1 gusht 1996 janë marrë deklarime nga babai, nëna dhe motra e viktimës, si dhe nga tre të afërm të tij, ndërsa më datë 5 gusht është kryer edhe kontrolli i banesës, ku autori i dyshuar L.Xh. kishte qëndruar përpara ngjarjes së rrëmbimit, banesë e cila në momentin e kontrollit ishte shitur dhe aty po kryheshin punime. Në vijim, në datat 1 shtator dhe 7, 21, 28 dhe 29 tetor të atij viti janë marrë deklarime nga 8 shtetas që kanë pasur dijeni për ngjarjen e rrëmbimit, autorët e mundshëm të saj apo për rrethanat e ndodhura më pas. Pas kësaj, megjithëse janë nisur disa njoftime për pyetjen ose ripyetjen e disa shtetasve, nuk rezultoi nga aktet që një gjë e tillë të ketë ndodhur, ndërkohë që afatet 3-mujore të hetimit, duke filluar nga data 20.2.1996, janë zgjatur disa herë deri më datë 30.7.1997.

5. Prokuroria Fier ka urdhëruar shoqërimin e autorit kryesor të dyshuar, shtetasit L.Xh., por sipas një raporti policor, që daton më 16.5.1997, ai nuk

është gjetur në banesë dhe rezultonte të ishte larguar jashtë vendit. Ndërkohë, ky shtetas rezultoi të ketë vdekur më datë 23.5.1997, sipas një certifikate të gjendjes civile të lëshuar në qershor të vitit 1997. Pasi ka ardhur në dijeni për këtë fakt, Prokuroria Fier ka vendosur pushimin e procedimit penal në ngarkim të shtetasit L.Xh. Në këtë vendim është arritur në përfundimin se ky shtetas është autor i veprës penale, ndërsa pranohet se viktimë është rrëmbyer forcërisht nga ai dhe disa persona të tjerë dhe se gjatë rrëmbimit viktimë ka thirrur: “Më vranë shokët e Ladit”, “O Luan, ç’të kam bërë”. Shtetasi L.Xh. ka qenë shok i vëllait të viktimës, Ladit dhe kjo shoqëri është shtuar më shumë kur ky i fundit ka qenë në burg. Ai ka pasur një makinë që e parkonte te lokali i viktimës, makinë të cilën një natë ia morën. Të nesërmen shtetasi L.Xh. ka takuar viktimën, të cilit i ka thënë: “Po e gjeta makinën, nuk e dua, por atij personit do t’i fus plumbat në kokë”. Një ditë pas rrëmbimit të viktimës, një i afërt (shtetasi A.V) dhe dy shokë të tij kanë takuar shtetasin Sh.G., që ishte shok me L.Xh., i cili u ka thënë se viktimë ishte fajtor dhe do ta mbanin deri sa të gjendej makina. Më pas, viktimë është gjetur i vrarë dhe i groposur. Në vijim, me vendimin e datës 17.6.1997, bazuar në nenin 326, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Procedurës Penale (KPP), Prokuroria Fier ka vendosur pezullimin e hetimeve për zbulimin e autorëve të tjerë të paidentifikuar.

6. Hetimet kanë mbetur në këtë gjendje deri më datë 20.9.2017, kur oficeri i Policisë Gjyqësore i ka sugjeruar prokurorit rifillimin e tyre, me arsyetimin se ishte plotësuar afati i parashkrimit të ndjekjes penale. Më datë 22.9.2017, Prokuroria Fier ka vendosur rifillimin e hetimeve të pezulluara, ndërsa më datë 6.10.2017, bazuar në nenin 329/a të lidhur me nenin 328/a, pika 1, shkronja “d”, të KPP-së, prokurori i ka kërkuar gjykatës të pushonte çështjen penale. Sipas prokurorit, nga çasti i kryerjes së veprës penale kishin kaluar më shumë se 20 vjet, prandaj ndjekja penale nuk mund të vazhdonte për shkak të parashkrimit të saj.

7. Kërkesa e prokurorit është shqyrtuar në seancë gjyqësore publike, në të cilën ka marrë pjesë edhe motra e viktimës, kërkuësja, e cila ka kundërshtuar kërkesën e prokurorit. Në përfundim të shqyrtimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier (gjyqtari i seancës paraprake), me vendimin nr. 62-2018-181(30), datë 19.1.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për pushimin e çështjes penale, duke urdhëruar kthimin



e akteve të procedimit penal Prokurorisë Fier për vazhdimin e hetimeve. Sipas gjykatës, në rastin konkret gjen zbatim neni 66 i KP-së, paragrafi 2, i ndryshuar me ligjin nr. 36/2017, datë 30.3.2017, sipas të cilit nuk i nënshtrohen parashkrimit veprat penale të parashikuara nga nenet 76–79/c të këtij kodi, ndërkohë që cilësimi i duhur i veprës penale në këtë rast është “Vrasja me paramendim”, e kryer në bashkëpunim dhe në rrethana rëndësuese, e parashikuar nga nenet 78/2 e 25 të KP-së. Po kështu, gjykata ka vlerësuar si të paplota veprimet hetimore të prokurorisë, duke evidentuar 20 të tilla si të nevojshme për t’u kryer, përveçse edhe çdo veprim tjetër që mund të lindte i nevojshëm për sqarimin e rrethanave të ngjarjes dhe identifikimin e autorëve. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim prokuroria.

8. Gjkata e Apelit Vlorë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 206, datë 29.3.2018, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit dhe urdhëruar pushimin e çështjes penale. Sipas gjykatës së apelit, afati maksimal 20-vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale, sipas nenit 66, shkronja “a”, të KP-së, ishte plotësuar që më datë 6.12.2015, pra përpara ndryshimeve të kësaj dispozite me ligjin nr. 36/2017. Fakti që kërkesa e prokurorit për pushimin e çështjes penale është paraqitur pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 36/2017, nuk e bën të zbatueshëm nenin 66, paragrafi 2, të këtij ligji në lidhje me mosparashkrimin e ndjekjes penale, për sa kohë ky parashkrim është plotësuar një vit e gjysmë përpara hyrjes së tij në fuqi, sipas përcaktimeve të shkronjës “a” të kësaj dispozite të pandryshuar, e cila është e zbatueshme në këtë rast si ligji në fuqi në kohën e plotësimit të afatit të parashkrimit të ndjekjes penale. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuësja.

9. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pas shqyrtimit të rekursit në seancë gjyqësore me praninë e palëve, me vendimin nr. 00-2023-1038(123), datë 18.4.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, duke vlerësuar se ai është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe atij material. Sipas asaj gjykate, forma e gjykimit në dhomën e këshillimit e ndjekur nga gjykata e apelit është në përputhje me ligjin procedural në fuqi në kohën e gjykimit, referuar neneve 329/a dhe 329/b në lidhje me nenin 329, pika 6, të KPP-së. Në vijim, sipas Gjykatës së Lartë,

gjykata e apelit ka zbatuar drejt edhe ligjin material në lidhje me parashkrueshmërinë e ndjekjes penale dhe momentin procedural të plotësimit të afatit të parashkrimit në rastin konkret. Ajo gjykatë ka arsyetuar se instituti i parashkrimit të ndjekjes penale nënkupton pamundësinë e shtetit (organeve të ndjekjes penale) për të kryer hetime dhe për të vendosur përpara përgjegjësisë penale çdo person, i cili dyshohet për kryerjen e një vepre penale, nëse vërtetohet fakti juridik me karakter shues i kalimit të afatit kohor nga momenti i kryerjes së veprës penale deri në momentin e marrjes të pandehur të këtij personi. Në rastin konkret, referuar ligjit (nenit 66 të KP-së) në fuqi në kohën kur ka ndodhur vepra penale e rrëmbimit dhe më pas vrasja e viktimës, evokohet pamundësia e ushtrimit të ndjekjes penale në kushtet e ndërhyrjes së shkakut pengues, atij të parashkrimit, shuarjes së afatit të ushtrimit të saj, për sa kohë që nga kryerja e veprës penale deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar 20 vjet për krimet që parashikojnë dënim jo më të ulët se 10 vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë. Gjkata e Lartë është shprehur se ndryshimet e KP-së me ligjin nr. 36/2017, që kanë përcaktuar mosparashkrimin e ndjekjes penale për veprat penale të parashikuara nga nenet 76–79/c të KP-së, kanë hyrë në fuqi në kohën kur afati 20-vjeçar i parashkrimit të veprës penale në rastin konkret ka qenë i konsumuar, ndaj ato nuk mund të shtrijnë efektet për ndjekjet penale të parashkruara përpara kësaj periudhe.

10. Më datë 19.10.2023, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjkata*), me kërkesën sipas objektit, e cila, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar më datë 9.11.2023. Më datë 12.1.2024, Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 31, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 6.2.2024, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se Gjykata e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Lartë kanë cenuar:



11.1 *Të drejtën për proces të rregull ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Apelit Vlorë ka disponuar në dhomën e këshillimit në shkellje të nenit 426/a të KPP-së dhe së bashku me Gjykatën e Lartë kanë keqinterpretuar dhe keqzbatuar ligjin material për sa i takon parashkrimit të ndjekjes penale, pasi e drejta e jetës së viktimës nuk mund të jetë në të njëjtën baraspeshë me të drejtën e sigurisë juridike të autorit të veprës penale dhe se ky institut nuk nënkupton pasivitetin e organit të ndjekjes penale për zbardhjen e ngjarjes dhe të autorëve të saj. Për më tepër, sipas kërkuësës, afati 20-vjeçar për parashkrimin e ndjekjes penale nuk është plotësuar, pasi afatet e hetimit kanë ecur nga data 11.11.1995 deri më datë 17.6.1997, kur ato janë pezulluar, dhe kanë rifilluar më datë 22.9.2017, kohë kur kishte hyrë në fuqi ligji nr. 36/2017, që ka ndryshuar edhe nenin 66 të KP-së, sipas paragrafit 2 të të cilit vepra penale e kryer në rastin konkret hyn në kategorinë e atyre veprave që nuk i nënshtrohen parashkrimit të ndjekjes penale.

11.2 *Të drejtën e jetës*, të garantuar nga neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ, për shkak të mungesës së hetimeve të plota dhe efektive. Përgjatë një periudhe 22-vjeçare, pavarësisht ankesave të herëpashershme të familjarëve të viktimës, ndërsa ligji i kohës nuk njihnte të drejtat e viktimës në procesin penal, strukturat policore dhe ato hetimore kanë qëndruar pasive dhe indiferente. Ato nuk kanë kryer veprimet e domosdoshme hetimore për zbulimin dhe vënien përpara përgjegjësisë të autorëve të një vepre penale shumë të rëndë, siç është ajo e vrasjes me paramendim në bashkëpunim dhe në rrethana cilësuese, ndonëse kanë pasur të gjitha indiciet e nevojshme për një hetim të shpejtë të çështjes dhe identifikimin e autorëve, të cilët, në fakt, kanë qenë të identifikuar, pasi janë thirrur nga prokurori dhe u janë kontrolluar edhe banesat. Pasiviteti dhe shkeljet në hetimin e çështjes kanë filluar që me këqyrjen e mangët të vendit ku viktimë është rrëmbyer, duke vijuar me kualifikimin e veprës penale për të cilën është regjistruar procedimi penal dhe, më tej, me moskryerjen e veprimeve të plota hetimore për zbardhjen e plotë të ngjarjes, ndërsa pas qershorit të vitit 1997 me moskryerjen e asnjë veprimi hetimor.

12. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

12.1 Pretendimi për *cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor* të lidhur me keqinterpretimin e ligjit material për sa i takon parashkrimit të ndjekjes penale për shkak të ndryshimit të mëvonshëm të KP-së është i pabazuar. Gjykata e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Lartë, në analizë kronologjike të ngjarjes dhe ndryshimeve ligjore, kanë arritur me të drejtë në konkluzionin se ndjekja penale në lidhje me ngjarjen e vrasjes në vitin 1995 është shuar, pasi është konstatuar se afati 20-vjeçar i parashkrimit ka përfunduar përpara datës kur kanë hyrë në fuqi ndryshimet e KP-së të bëra me ligjin nr. 36/2017, i cili ka përjashtuar nga parashkrimi (shuarja) ndjekjen penale të autorëve të krimeve me dashje kundër jetës. Gjithashtu, edhe pretendimi për shkelje të nenit 426/a të KPP-së nga gjykata e apelit është i pabazuar, pasi në zbatim të neneve 329/a dhe 329/b të KPP-së, si dhe në referim të rrethanave faktike të çështjes në shqyrtim, të provuara gjyqësisht, shqyrtimi i çështjes nga ajo gjykatë në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve është konform kërkesave ligjore.

12.2 Pretendimi për *cenimin e së drejtës së jetës* nuk qëndron, pasi autoritetet e ngarkuara me ligj e kanë kryer në mënyrë efikase detyrimin e tyre kushtetues dhe ligjor në drejtëm të hetimit dhe zbulimit të rrethanave të ngjarjes dhe autorëve të kryerjes së veprës penale. Veprimet e shumta hetimore të kryera kanë dëshmuar faktin se prokuroria ka treguar diligjencën e duhur në drejtëm të hetimeve, të cilat çuan në identifikimin e autorit kryesor të ngjarjes dhe pushimin e hetimeve për shkak të vdekjes së tij më datë 23.5.1997. Ndërsa në lidhje me bashkautorët e tjerë, pavarësisht kryerjes së të gjitha veprimeve të mundshme hetimore, nuk ka arritur në identifikimin e tyre, ndaj ka vendosur pezullimin e hetimeve. Po kështu, kërkuësja është ankuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme lidhur me pretendimet për fazën e hetimit dhe ka marrë përgjigje lidhur me to. Sipas saj, Gjykata nuk gjendet në kushtet kur mund të dalë jashtë objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të, në mënyrë autonome, pasi nuk rezulton të gjendet ndonjë lidhje midis objektit të kërkesës me ndonjë akt tjetër normativ, lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës kushtetuese të jetës.



III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkujes

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Gjykata vlerëson se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi në cilësinë e familjares së afërt të viktimës së veprës penale (*motra e të ndjerit*) ka qenë palë në procesin gjyqësor ku është vendosur pushimi i çështjes penale të regjistruar fillimisht për rrëmbimin dhe më pas vrasjen e familjarit të afërt të saj, proces për të cilin, sikundër edhe për procesin penal në tërësi, ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual, ndaj për rrjedhojë provon interesin e saj në çështjen e parashtruar si viktimë jo e drejtpërdrejtë e shkeljeve të pretenduara gjatë këtij procesi.

15. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuësja i është drejtuar asaj duke ngritur pretendime për procesin penal në tërësi që është përmbyllur në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual, ndaj ajo e ka plotësuar edhe këtë kriter.

16. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin e kundërshtimit të

vendimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin 4-mujor nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes njoftimit elektronik të tij, kur palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin në shqyrtim, duke mbajtur në konsideratë se kërkuësja ankohet për rezultatin e procesit penal i cili është përmbyllur me vendimin e dhënë nga Gjykata e Lartë më datë 18.4.2023, nisur nga fakti se ky vendim i është njoftuar kërkuësës në adresën elektronike të avokates së saj më datë 23.6.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur më datë 19.10.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor, Gjykata çmon se kërkuësja legjitimohet edhe *ratione temporis*.

18. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuësja në objektin e ankimit kushtetues ka parashtruar formalisht dy kërtime: *i pari*, për shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe Gjykatës së Lartë, për shkak të mosrespektimit të garancive të nenit 42 të Kushtetutës; *i dyti*, për interpretimin e nenit 66 të KP-së. Për sa i takon kërkit të dytë, Gjykata konstaton se ai është në themel të kërkit të parë, ndaj do të trajtohet si pjesë e tij. Në lidhje me shfuqizimin e dy vendimeve gjyqësore kërkuësja ka pretenduar se gjykatat respektive kanë interpretuar gabim ligjin material për sa i takon nenit 66 të KP-së, ndërsa gjykata e apelit ka zbatuar gabim edhe ligjin procedural për sa i takon formës së gjykimit në dhomën e këshillimit, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën kushtetuese të jetës së viktimës dhe familjarëve të tij, për shkak të mangësive të procedimit penal, i cili ka përfunduar me vendim pushimi.

19. Gjykata çmon t'i analizojë pretendimet e kërkuësës nën dritën e standardeve që garantojnë ushtrimin e të drejtave kushtetuese procedurale dhe substanciale. Në këtë optikë, bazuar në thelbin e pretendimeve, Gjykata vlerëson t'i trajtojë ato të grupuara në: (i) pretendime ndaj procesit gjyqësor të shqyrtimit të kërkesës së prokurorisë për pushimin e procedimit penal të konkluduar me vendimin e Gjykatës së Lartë, duke i analizuar në këndvështrim të *së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës; (ii) pretendime ndaj cilësisë së hetimeve të vrasjes së vëllait të kërkuësës, duke i analizuar në këndvështrim të *së drejtës kushtetuese të jetës, në aspektin procedural*, të garantuar nga neni 21 i Kushtetutës.



20. Për sa u takon pretendimeve që lidhen me cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, kërkuesja ka argumentuar se gjykata e apelit ka shkelur nenin 426/a të KPP-së, në lidhje me formën e gjykimit në dhomën e këshillimit, ndërsa së bashku me Gjykatën e Lartë kanë keqinterpretuar ligjin material penal për sa i takon parashkrimit të ndjekjes penale, pasi e drejta e jetës së viktimës nuk mund të jetë në të njëjtën baraspeshë me të drejtën e sigurisë juridike të autorit të veprës penale dhe se ky institut nuk nënkupton pasivitetin e organit të ndjekjes penale për zbardhjen e ngjarjes dhe të autorëve të saj. Për më tepër, sipas saj, afati 20-vjeçar për parashkrimin e ndjekjes penale nuk është plotësuar, pasi afatet e hetimit kanë ecur nga data 11.11.1995 deri më datë 17.6.1997, kur ato janë pezulluar dhe kanë rifilluar më datë 22.9.2017, kohë kur kishte hyrë në fuqi ligji nr. 36/2017 që ka ndryshuar edhe nenin 66 të KP-së, sipas paragrafit 2 të të cilit vepra penale e kryer në rastin konkret hyn në kategorinë e atyre veprave që nuk i nënshtrohen parashkrimit të ndjekjes penale.

21. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se referuar nenit 66 të KP-së së pandryshuar, nga koha kur ka ndodhur vepra penale e rrëmbimit dhe më pas e vrasjes së vëllait të kërkueses në vitin 1995 kanë kaluar më shumë se 20 vjet, ndaj gjykatat në analizë kronologjike të ngjarjes dhe ndryshimeve ligjore kanë arritur me të drejtë në konkluzionin se ndjekja penale është shuar. Sipas subjektit të interesuar, afati 20-vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale ka përfunduar përpara datës kur kanë hyrë në fuqi ndryshimet e KP-së të bëra me ligjin nr. 36/2017, i cili ka përjashtuar nga parashkrimi (shuarja) ndjekjen penale të autorëve të krimeve me dashje kundër jetës. Po kështu, për sa i takon zbatimit të nenit 426/a të KPP-së nga gjykata e apelit, sipas subjektit të interesuar, shqyrtimi i çështjes nga ajo gjykatë në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve është konform kërkesave të ligjit procedural në fuqi.

22. Gjykata ka theksuar se zbatimi i ligjit është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm. Kjo do të thotë se Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të

juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që e bën të padrejtë gjykimin (*shih vendimet nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 30, datë 29.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se veprat penale, fillimisht ajo e rrëmbimit dhe më pas e vrasjes së viktimës, kanë ndodhur në nëntor të vitit 1995, ndërsa hetimi penal me qëllim zbulimin e autorëve është pezulluar në qershor të vitit 1997. Në vijim, në shtator të vitit 2017 prokuroria ka rifilluar hetimet dhe bazuar në nenin 66 të KP-së (përpara ndryshimeve me ligjin nr. 36/2017), për shkak se ka konstatuar se është tejkaluar afati 20-vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale, ka kërkuar pushimin e çështjes penale. Gjykata e shkallës së parë ka rrëzuar kërkesën e prokurorisë, duke urdhëruar vijimin e hetimit, me argumentin se referuar parashikimit të nenit 66 të KP-së të ndryshuar me ligjin nr. 36/2017, vepra penale e kryer në rastin konkret nuk i nënshtrohet parashkrimit të ndjekjes penale. Në të kundërt të këtij arsyetimi, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë pranuar kërkesën e prokurorisë, duke vendosur pushimin e çështjes penale, duke analizuar ligjin në fuqi në kohën e plotësimit të afatit të parashkrimit. Ato kanë argumentuar se referuar parashikimit të nenit 66 të KP-së (përpara ndryshimeve me ligjin nr. 36/2017), afati 20-vjeçar për parashkrimin e ndjekjes penale ishte plotësuar më datë 6.12.2015, më shumë se një vit e gjysmë përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve të KP-së, ndryshime të cilat nuk mund të zbatoheshin për periudhën e mëparshme. Pra, sipas tyre, ligji i zbatueshëm është ligji në fuqi në kohën e plotësimit të afatit 20-vjeçar të parashkrimit të ndjekjes penale dhe kur subjekti i interesuar legjitimohej për të kërkuar pushimin e çështjes penale për shkak të shuarjes së ndjekjes penale.

24. Gjykata, në vështtrim të thelbit të kërimit, vëren se argumentet e kërkueses kanë të bëjnë me interpretimin e nenit 66 të KP-së të lidhur me aplikimin në kohë të tij për sa i takon institutit të parashkrimit të ndjekjes penale të krimit të vrasjes. Lidhur me këtë, nga përmbajtja e të dyja vendimeve objekt kundërshtimi, ajo vë në dukje se kjo dispozitë penale materiale rezulton e analizuar hollësisht nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë. Kjo e fundit në rolin e gjykatës së ligjit, në përputhje me



kompetencat e saj kushtetuese dhe ligjore, ka interpretuar këtë dispozitë dhe institutin e parashkrimit të ndjekjes penale në një mënyrë që nuk duket e paarsyeshme dhe arbitrare, sikundër as nuk evidentohet ndonjë gabim ligjor ose faktik i dukshëm. Për pasojë, procesi në këtë pikëpamje nuk duket të jetë i parregullt. Gjykata vlerëson të theksojë se ligji nr. 36/2017, për sa i përket ndryshimit të nenit 66 të KP-së, nuk parashikon zbatimin e tij për veprat, ndjekja penale e të cilave në kohën e hyrjes së tij në fuqi ishte parashkruar, çka mund të vinte në diskutim respektimin e parimit të shtetit të së drejtës në drejtim të sigurisë juridike dhe atë të barazisë para ligjit. Po ashtu, Gjykata çmon se edhe shqyrtimi i ankimit nga gjykata e apelit në dhomën e këshillimit, mbi bazë të dokumenteve, nuk rezulton të jetë në shkellje të dispozitave procedurale penale që kanë qenë në fuqi në momentin e gjykimit të çështjes, pasi një formë e tillë gjykimi është lejuar nga ligji, sikurse edhe Gjykata e Lartë ka argumentuar dhe që me të drejtë është prapësuar nga subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e kërkuases në lidhje me procesin dhe vendimet e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë, që kanë pranuar pushimin e çështjes penale për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

25. Nga ana tjetër, Gjykata evidenton se ndonëse formalisht Gjykata e Lartë ka përmbushur detyrimin e saj për të kontrolluar vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, ajo nuk ka bërë pjesë të kontrollit dhe të vlerësimit të saj, nisur nga rrethanat specifike të rastit në shqyrtim, të drejtën kushtetuese të jetës në aspektin e cilësisë së hetimeve të vendosur në themel të rekursit të kërkuases, pra nëse hetimet e shtrira në kohë për 20 vjet kanë qenë efektive dhe të plota dhe se për këtë shkak e drejta kushtetuese e jetës ka qenë e garantuar nga autoritetet shtetërore sipas standardeve kushtetuese. Lidhur me këtë aspekt të procesit, Gjykata rithekson se në zbatim të parimit të *subsidiaritetit*, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është funksion edhe i Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 16, datë 12.3.2024; nr. 12, datë 24.5.2022; nr. 65, datë 16.10.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon të theksojë se mungesa e vlerësimit të fakteve dhe e një përgjigjeje për këtë pretendim të familjarëve të afërt të viktimës, në kushtet kur procesi penal në rastin konkret nuk mund të vazhdojë për shkak të

parashkrimit të ndjekjes penale dhe për pasojë nuk mund të ketë ndreqje për ankesën e kërkuases, do të sillte mohim të mbrojtjes së të drejtës substanciale, në një kohë kur ankimi kushtetues individual synon të shërbejë si një mjet efektiv brenda sistemit të brendshëm, me qëllim garantimin dhe mbrojtjen sa më të përshtatshme të të drejtave dhe lirive themelore të individit (*shih vendimin nr. 18, datë 19.3.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Thënë kjo, prapësimi i subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, se referuar nenit 48 të ligjit nr. 8577/2000 nuk rezulton të gjendet ndonjë lidhje midis objektit të kërkesës me ndonjë akt tjetër normativ, për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës kushtetuese të jetës, është i pabazuar.

27. Për sa më lart, Gjykata çmon të shqyrtojë në themel pretendimet që lidhen me cenimin e *së drejtës së jetës*, të adresuara rreth cilësisë së hetimeve, domethënë *në aspektin procedural* të kësaj të drejte, të mbrojtur nga neni 21 i Kushtetutës, pra për sa i përket përmbushjes nga autoritetet shtetërore kompetente të detyrimeve të tyre kushtetuese dhe ligjore për respektimin e saj.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së jetës

28. Kërkuësja ka pretenduar se përgjatë një periudhe 22-vjeçare, pavarësisht ankesave të herëpashershme të familjarëve të viktimës, ndërsa ligji i kohës nuk njihte të drejtat e viktimës në procesin penal, strukturat policore dhe ato hetimore kanë qëndruar pasive dhe indiferente, duke mos kryer veprimet e domosdoshme hetimore për zbulimin dhe vënien përpara përgjegjësisë të autorëve të një veprë penale shumë të rëndë, siç është ajo e vrasjes me paramendim në bashkëpunim dhe në rrethana cilësuese, ndonëse kanë pasur të gjitha indiciet e nevojshme për një hetim të shpejtë të çështjes dhe identifikimin e autorëve, të cilët, në fakt, kanë qenë të identifikuar, pasi janë thirrur nga prokurori dhe u janë kontrolluar edhe banesat. Pasiviteti dhe shkeljet në hetimin e çështjes kanë filluar që me këqyrjen e mangët të vendit ku viktimë është rrëmbyer, duke vijuar me kualifikimin e veprës penale për të cilën është regjistruar procedimi penal dhe, më tej, me moskryerjen e veprimeve të plota hetimore për zbardhjen e plotë të ngjarjes, ndërsa pas qershorit të vitit 1997 me moskryerjen e asnjë veprimi hetimor.

29. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se autoritetet e



ngarkuara me ligj kanë kryer në mënyrë efikase detyrimin e tyre kushtetues dhe ligjor në drejtëm të hetimit dhe zbulimit të rrethanave të ngjarjes dhe autorëve të kryerjes së veprës penale. Policia dhe prokuroria kanë ndërmarrë hetime të shpejta, duke dokumentuar menjëherë ngjarjen, respektivisht duke referuar ngjarjet e ndodhura në data të ndryshme dhe regjistruar çështje penale për to në dy prokuroritë përkatëse në rrethe të ndryshme dhe në vijim duke kryer një sërë veprimesh hetimore me synim zbardhjen e rrethanave të ngjarjes dhe zbulimin e vënien përpara përgjegjësisë ligjore të autorëve të kryerjes së veprave penale. Gjatë kryerjes së hetimeve paraprake është bërë bashkimi i dy procedimeve të ndryshme në një të vetëm dhe në vazhdimësi janë vlerësuar të gjitha pretendimet e parashtruara nga kërkuesja që rezultonte se kishte dijeni. Veprimet e shumta hetimore të kryera kanë çuar në identifikimin e autorit kryesor të ngjarjes. Ndërsa në lidhje me bashkautorët e tjerë, pavarësisht kryerjes së të gjitha veprimeve të mundshme hetimore, nuk është arritur në identifikimin e tyre. Periudha e pezullimit të hetimeve, sipas prokurorisë, konsiderohet si një periudhë hetimi joaktiv dhe se gjatë saj policia ka si detyrë kryesore identifikimin e burimeve për prova të tjera që do të mund ta sjellin procedimin në një fazë aktive nëpërmjet rifillimit të tyre. Po kështu, shprehet prokuroria, kërkuesja është ankuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe ka marrë përgjigje lidhur me pretendimet e saj.

30. Neni 21 i Kushtetutës parashikon se jeta e personit mbrohet me ligj. Gjykata ka pohuar se njeriu dhe jeta e tij janë vlerat më superiore për shtetin dhe se kjo e drejtë qëndron në themel të të gjitha të drejtave dhe mohimi i saj sjell edhe eliminimin e të drejtave të tjera njerëzore. Koncepti për jetën dhe dinjitetin njerëzor paraqiten në dispozitat e Kushtetutës si vlera shumë të rëndësishme, të cilat konsiderohen si burimi nga i cili rrjedhin të gjitha të drejtat e tjera si të drejta themelore absolute. Jeta njerëzore bëhet një vlerë mbi të gjitha vlerat e tjera që mbrohet nga Kushtetuta. Ky është dhe qëllimi i Kushtetutës sonë, i cili del që në Preambulën e saj, si dhe në mjaft dispozita të tjera (*shih vendimin nr. 65, datë 10.12.1999 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjithashtu, e drejta për jetën garantohet edhe nga neni 2 i KEDNJ-së, e cila është analizuar dhe trajtuar nga GJEDNJ-ja. Në praktikën e saj ajo ka theksuar se e drejta e jetës, në aspektin procedural,

kërkon kryerjen e hetimeve efektive nga organi i ndjekjes penale për zbulimin e rrethanave të ngjarjes dhe autorit të saj, të cilat duhet të jenë, ndër të tjera, të plota, të paanshme dhe të kujdesshme. Pavarësisht se nuk përbën detyrim për arritjen e rezultatit, por për përdorimin e mjeteve, çdo mangësi në hetim, e cila rrezikon përcaktimin e rrethanave të çështjes ose personin përgjegjës, cenon standardin e efektivitetit (*shih Prizreni kundër Shqipërisë, datë 11.6.2019, § 42; McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 27.9.1995, §§ 161-163*). Për të qenë “efektiv” në kontekstin e nenit 2 të Konventës, hetimi duhet së pari të jetë i përshtatshëm (*shih Ramsabai dhe të tjerët kundër Holandës [DHM], datë 15.5.2007, § 324*). Kjo do të thotë se ai duhet të jetë në gjendje të vërtetojë faktet dhe, sipas rastit, të arrijë të identifikojë dhe ndëshkojë përgjegjësit (*shih Jaloud kundër Holandës [DHM], datë 20.11.2014, § 186; Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë [DHM], datë 26.2.2004, § 160*). Dështimi për të ndjekur një linjë të qartë hetimi cenon në një masë vendimtare aftësinë e hetimit për të vërtetuar rrethanat e rastit dhe, aty ku është e përshtatshme, identitetin e atyre që janë përgjegjës (*shih Kolevi kundër Bullgarisë, datë 5.11.2009, § 201*). Hetimi merr një rëndësi edhe më të madhe kur rezulton vdekja e viktimës, duke pasur parasysh faktin se qëllimi thelbësor i një hetimi të tillë është të sigurojë zbatimin efektiv të ligjeve vendase që mbrojnë të drejtën për jetë (*shih Angelova dhe Iliev kundër Bullgarisë [DHM], datë 26.7.2007, § 94*).

32. Megjithatë, GJEDNJ-ja ka pohuar se neni 2 i KEDNJ-së nuk imponon një detyrim për autoritetet hetuese për të përmbushur çdo kërkesë për veprime të caktuara hetimore të bërë nga një i afërm gjatë hetimit (*shih Ramsabai dhe të tjerët kundër Holandës [DHM], datë 15.5.2007, § 348; Velcea dhe Mazăre kundër Rumanisë, datë 1.12.2009, § 113*). Kur bëhet fjalë për vërtetimin e fakteve dhe duke pasur në konsideratë natyrën subsidiare të gjykimit të saj, ajo ka theksuar se duhet të jetë e kujdesshme në marrjen e rolit të një gjykate fakti, përveçse kur kjo është e pashmangshme nga rrethanat e një rasti konkret. Aty ku janë zhvilluar procese të brendshme, nuk është detyrë e saj të zëvendësojë vlerësimin e fakteve prej saj me atë të gjykatave vendase dhe u takon këtyre të fundit të vërtetojnë faktet në bazë të provave përpara tyre (*shih Ataykaya kundër Turqisë, datë 22.7.2014, § 47; Leyla Alp dhe të tjerët kundër Turqisë, datë 10.12.2013, § 76*).



33. Në analizë të standardeve të jurisprudencës së GJEDNJ-së në lidhje me të drejtën e jetës, në aspektin procedural, Gjykata, fillimisht, thekson se nuk është detyrë e saj të përcaktojë faktet dhe fajësinë e autorëve të veprës penale dhe as të interpretojë ligjin penal, detyrë e cila i përket prokurorisë dhe gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në këtë kuptim, duke pasur parasysh edhe parimin e subsidiaritetit, për të vlerësuar respektimin e së drejtës kushtetuese të jetës, Gjykata duhet të analizojë nëse hetimet nga organi i ndjekjes penale kanë qenë efektive, pra nëse ato kanë qenë të përshtatshme, të plota, të paanshme, të kujdesshme dhe kanë ndjekur një linjë të qartë në funksion të zbulimit të rrethanave të ngjarjes dhe identifikimit të autorëve të saj. Gjithashtu, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në kontekst të rrethanave specifike të rastit, i kanë dhënë përgjigje pretendimit kushtetues për të drejtën e jetës në aspektin procedural, pra nëse kanë vlerësuar faktet dhe arsyetuar në lidhje me efektivitetin e hetimeve në raport me të drejtën e jetës. Prandaj, në vijim, Gjykata do të analizojë nëse këto standarde përmbushen në rastin në shqyrtim.

34. Gjykata, duke pasur parasysh edhe rrethanat e çështjes, çmon të evidentojë se deri përpara ndryshimeve të KPP-së me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, viktimja nga vepra penale gëzonte të drejtën për të kërkuar fillimin e procedimit penal të fajtorit dhe shpërblimin e dëmit nga vepra penale, por nuk gëzonte të drejtën e informimit për gjendjen e procedimit, pjesëmarrjes dhe mbrojtjes me mjete ligjore procedurale efektive, duke mos pasur kështu viktimja aksesin e duhur në procesin penal, qoftë në fazën e hetimeve paraprake, ashtu edhe në atë të gjykimit më pas.

35. Duke iu kthyer çështjes, Gjykata konstaton se më datë 10.11.1995, në orën 22:15, në Vlorë, është dhunuar fizikisht dhe rrëmbyer me forcë viktimja e ngjarjes në fjalë, i cili ishte duke fjetur në makinën e tij poshtë pallatit ku familja banonte dhe pranë lokalit të babait. Sipas informacionit për referimin e veprës penale të datës 11.11.1995 të Komisarariatit të Policisë Vlorë, akti ka ndodhur nga disa persona të paidentifikuar dhe në rrethana të panjohura, ndërsa në vendin e ngjarjes janë gjendur rrobat e viktimës, si dhe një gur i gjakosur me të cilin është dyshuar të jetë goditur viktimja. Për dokumentimin e veprës penale rezulton se këqyrja e vendit të ngjarjes është bërë ditën e nesërme dhe gjatë këqyrjes janë fiksuar

e marrë disa sende si prova materiale, të cilat nuk del t'i jenë nënshtruar ndonjë ekzaminimi të mëtejshëm shkencor. Po ashtu, gjatë këqyrjes nuk del të jenë përdorur metoda shkencore për fiksimin e gjurmëve të mundshme të veprës penale, të cilat mund të çonin më pas në identifikimin e autorëve të saj. Lidhur me këtë mund të përmendet se disa nga deklaruesit kanë bërë prezent faktin se në vendin e ngjarjes ka pasur disa bishta cigaresh ende të ndezura, të cilat duhet të ishin hedhur nga autorët e rrëmbimit të viktimës, por nuk evidentohen në këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe nuk janë sekuestruar dhe nënshtruar ekzaminimeve shkencore të mëtejshme. Gjithashtu, për dokumentimin e veprës penale janë administruar edhe procesverbalet e kallëzimit të krimit nga kërkuesja dhe deklarime nga persona që kishin dijeni për ngjarjen, por pavarësisht faktit se për ngjarjen kanë ardhur në dijeni një rreth shumë më i madh personash, ata nuk janë pyetur menjëherë ose nuk janë pyetur fare. Është fakt se prej datës 13.11.1995 janë ngritur dyshime për autorin kryesor të rrëmbimit të viktimës dhe për motivet e veprës penale, ndërsa është këqyrtur libri policor i marrjes së denoncimeve, ku është evidentuar edhe denoncimi verbal i shtetasit L.Xh. për vjedhjen e automjetit të tij më datë 7.11.1995, përfshirë edhe vendin e vjedhjes, në afërsi të lokalit të babait të viktimës. Për më tepër, më datë 14.11.1995 ky shtetas është shpallur në kërkim policor, në kategorinë e “shumë të kërkuarve”, pikërisht si autori kryesor i dyshuar për kryerjen e veprës penale, por ai nuk është kapur asnjëherë.

36. Rreth 26 ditë më vonë nga kjo ngjarje, më datë 6.12.1995, rastësisht, nga një banor i zonës, në një pyll në afërsi të fshatit Darëzezë, Fier, është gjetur i vrarë dhe i groposur viktimja e rrëmbyer. Për dokumentimin e kësaj ngjarjeje janë hartuar procesverbalet e këqyrjes së vendit të ngjarjes, ai i njohjes së viktimës, si dhe i marrjes së deklarimeve nga personi që ka gjetur viktimën e groposur, por edhe nga babai i autorit kryesor të dyshuar. Po ashtu, prokuroria ka urdhëruar kryerjen e ekspertimit mjekoligjor të viktimës, duke administruar edhe aktin përkatës, sikurse edhe aktin e ekspertimit balistik që mban datën 22.1.1996. Në kushtet kur dyshohej se autorët e veprës penale mund të ishin nga rrethi i Fierit, por ende të paidentifikuar dhe vepra penale e vrasjes ishte më e rëndë se ajo e rrëmbimit, më datë 27.12.1995, Prokuroria Vlorë ka



vendosur kalimin e akteve Prokurorisë së Fierit. Në muajt në vijim janë marrë deklarime vetëm nga familjarët e autorit kryesor të dyshuar, ndërsa nuk është kryer asnjë veprim tjetër hetimor me qëllim zbulimin e bashkëpunëtorëve të tij.

37. Për shkak të pasivitetit disamujor të prokurorisë për zbardhjen e rrëmbimit dhe vrasjes së djalit të tij, babai i viktimës i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme. Me urdhrin e datës 18.7.1996, bazuar në nenin 24, pika 4, të KPP-së, zëvendësprokurori i përgjithshëm ka urdhëruar kryerjen e disa veprimeve hetimore nga ana e Prokurorisë Fier, si: (i) të verifikohet kush e ka mbajtur kallëzimin e L.Xh. për vjedhjen e makinës, nëse kallëzimi është bërë me shkrim apo me gojë dhe çfarë veprimesh janë kryer për këtë gjë; (ii) të ripyetet babai i viktimës për të sqaruar gjerësisht në lidhje me personat e dyshuar si autorë të krimit; (iii) të ripyetet personat që kanë shkuar të parët në vendngjarje në Vlorë në lidhje me çfarë kanë dëgjuar të flasë në momentin e fundit viktimë; (iv) të pyetet vëllai i viktimës për problemet që ka pasur me shtetasin L.Xh. dhe nëse ka pasur shoqëri me të apo me persona të tjerë të dyshuar; (v) të pyetet kryeinspektori i Policisë Vlorë në lidhje me telefonatat kërcënuese, për verifikimet e kryera në lidhje me to dhe për problemet e tjera të ngjarjes, si për vjedhjen e makinës, për shoqërimin e shtetasit L.Xh. me vëllain e viktimës etj.; (vi) nëse gjatë veprimeve do të rezultojnë kontradikta, të kryhen të gjitha ballafaqimet e nevojshme për eliminimin e tyre; (vii) meqenëse L.Xh. ka fjetur para ngjarjes në shtëpinë e motrës së tij, banuese në Vlorë, por e larguar prej vitesh në Greqi, të bëhet kontrolli i banesës, pasi aty mund të gjenden gjurmë të krimit, siç mund të jenë rroba të ndotura me gjak, fishekë pistolette ose vetë arma etj.

38. Pas kësaj, Prokuroria Fier në fund të korrikut dhe në fillim të gushtit të vitit 1996 ka pyetur disa nga të afërmit e viktimës, të cilët kanë deklaruar rreth autorëve të mundshëm dhe motivit të rrëmbimit dhe më tej të vrasjes së viktimës. Ata kanë treguar edhe për rrethana dhe persona konkretë që kishin dijeni për to. Po në muajin gusht të këtij viti, në zbatim të urdhrin të prokurorit më të lartë, Prokuroria Fier ka kërkuar nga gjykata nxjerrjen e vendimit për kontrollin e banesës ku dyshohej se kishte qëndruar para ngjarjes autori i dyshuar L.Xh., kërkesë e cila është miratuar nga gjykata me vendimin e datës 3.8.1996, por nga kontrolli i kryer

më datë 5.8.1996 është konstatuar se ajo tashmë ishte shitur dhe se aty po kryheshin punime nga blerësi.

39. Vetëm më datë 1 shtator dhe përgjatë disa ditëve të muajit tetor të vitit 1996, Prokuroria Fier ka marrë deklarime nga 7 shtetas, ndërsa për ata për të cilët familjarët e viktimës dyshonin se kishin lidhje shoqërore me autorin kryesor të dyshuar, ka arritur të marrë deklarimet vetëm nga njëri prej tyre, ku pavarësisht se deklarimet e tij nuk përputheshin me ato të deklaruesve të tjerë, nuk rezulton të jetë bërë ballafaqimi mes tyre. Të afërmit e viktimës dhe deklaruesit kanë treguar edhe për persona të tjerë që mund të kishin dijeni për rrëmbimin e viktimës apo për rrethana që kanë ndodhur pas saj, por atyre nuk u është kërkuar dhënia e deklarimeve. Po ashtu, disa nga deklaruesit kanë dhënë të dhëna identifikuese për persona me të cilët autori kryesor ka qenë i shoqëruar ditët para ose dhe në atë të rrëmbimit të viktimës, por nuk është bërë ndonjë veprim konkret për marrjen e deklarimeve nga ata që janë identifikuar ose për identifikimin dhe marrjen e deklarimeve nga ata për të cilët janë dhënë vetëm karakteristikat trupore, përveç një shkrese të datës 14.2.1996, ku prokurori i kërkon Policisë Fier informacion për çdo të dhënë në lidhje me shtetasin L.Xh., kërkesë për të cilën nuk del të ketë marrë ndonjë përgjigje. Ndërkohë, autori kryesor i dyshuar nuk është gjetur dhe vetëm më datë 16.5.1997 shërbimet e policisë kanë informuar Prokurorinë Fier se ai nuk gjendej në banesë dhe rezultonte i larguar jashtë shtetit.

40. Në qershor të vitit 1997 zyra e gjendjes civile Fier ka lëshuar një certifikatë sipas së cilës shtetasi L.Xh. ka vdekur më datë 23.5.1997. Pasi ka administruar këtë certifikatë, Prokuroria Fier ka vendosur pushimin e procedimit penal në ngarkim të këtij shtetasi, duke u shprehur në vendimin e saj se nga analiza e provave dhe akteve të administruara në dosje, si dhe nga hetimi në tërësi, ai është njëri nga autorët e veprës penale.

41. Në vijim, po në qershor të vitit 1997, Prokuroria Fier ka pezulluar hetimet për zbulimin e autorëve të tjerë të paidentifikuar. Familjarët e viktimës nuk u informuan asnjëherë për këtë vendim dhe as për arsyet e tij. Pas këtij vendimi nuk ka asnjë veprim hetimor të dokumentuar. Hetimi ka rifilluar pas më shumë se 20 vjetësh, në shtator të vitit 2017, kur oficeri i Policisë Gjyqësore ka informuar prokurorin për kalimin e afatit të



parashkrimit të ndjekjes penale në atë çështje. Në vijim, Prokuroria Fier ka kërkuar pushimin e çështjes penale për këtë shkak.

42. Në përmbledhje të fakteve të mësipërme, Gjykata vëren se organi i prokurorisë ka kryer veprime për zbardhjen e ngjarjes dhe zbulimin e vënien përpara përgjegjësisë penale të autorëve të veprës përgjatë një periudhe prej një viti e shtatë muajsh (nëntor 1995–qershor 1997). Praktikisht ka pasur disa veprime aktive në tre muajt e parë, nëntor 1995–janar 1996, përgjatë të cilëve janë administruar disa akte të papërsëritshme (si këqyrja e vendit të ngjarjes dhe e kufomës), aktet përkatëse të ekspertimit mjekoligjor dhe balistik, si dhe disa deklarime nga babai i viktimës dhe banorë të zonës që kanë qenë pranë vendit të rrëmbimit të tij. Më pas, përgjatë 3 muajve (shkurt–prill 1996) janë marrë vetëm deklarime nga familjarë të autorit kryesor të dyshuar dhe në 3 muajt në vijim (maj–korrik 1996) nuk është kryer ndonjë veprim hetimor. Vetëm pas ankesës së babait të viktimës dhe urdhërimit nga zëvendësprokurori i Përgjithshëm (pas më shumë se 8 muajve nga ngjarja e rrëmbimit) janë kryer veprime të mëtejshme hetimore, ku në harkun kohor të 10 ditëve janë marrë deklarime nga familjarë dhe të afërm të viktimës, si dhe është bërë kontrolli i një banese ku kishte qëndruar autori kryesor i dyshuar, ndërsa përgjatë muajve të tjerë (deri në tetor 1996) janë marrë deklarime nga persona që kanë ardhur në dijeni për fakte të caktuara në lidhje me atë ngjarje. Po kështu, konstatohet se ndonëse ngjarja kriminale e rrëmbimit të një të riu të moshës 28-vjeçare dhe pa rekorde kriminale ka ndodhur në një zonë urbane me dendësi të lartë popullsie dhe është parë e dëgjuar nga shumë persona, hetimet për zbardhjen e saj dhe zbulimin e autorëve nuk kanë qenë efektive në kohë dhe në cilësi. Këtë mungesë efektiviteti e dëshmon edhe fakti se viktimë është gjetur rastësisht, pas 26 ditësh, i vrarë dhe i groposur, jo shumë larg vendit të rrëmbimit.

43. Gjithashtu, sipas deklarimeve të personave që kanë pasur dijeni për ngjarjen, rezulton se prokuroria, megjithëse ka pasur njoftime për motive të mundshme të kryerjes së veprës dhe për persona me të cilët autori kryesor mund të kishte bashkëpunuar në kryerjen e saj, nuk ka kryer veprime për verifikimin e plotë të saktësisë së tyre, përfshirë edhe marrjen e deklarimeve nga ata. Vetëm pasi është urdhëruar nga prokurori më i lartë, i cili është vënë në lëvizje nga ankesa e familjarëve të

viktimës, ajo prokurori ka kryer një hetim disi më të thelluar, por përsëri nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të urdhëruara, por as ato që kanë dalë të nevojshme në vijim. Po kështu, pavarësisht se prokuroria ka zgjatur disa herë afatet e hetimit, nuk rezulton që ato të justifikohen për kryerjen e veprimeve hetimore të dala rishtas, por për veprime që kanë qenë të nevojshme që në fillim të hetimeve. Për më tepër, asnjë person i dyshuar nuk është vënë para përgjegjësisë penale, megjithëse edhe ajo prokurori vetë, në vendimin e pushimit të procedimit penal ndaj shtetasit L.Xh., pranon se ai ka qenë autori kryesor i veprës, pra të paktën një nga autorët ka qenë i njohur, por kjo është pranuar vetëm pas vdekjes së tij. Gjithashtu, pezullimi i hetimit brenda një kohe relativisht të shkurtër nga ndodhja e ngjarjes së rëndë kriminale pa përfundime konkrete dhe mbi fakte të paqarta, bën që hetimi në tërësi të karakterizohet nga mangësi serioze, duke mos qenë në gjendje të vërtetonte faktet, të identifikonte në afat dhe plotësisht përgjegjësit dhe t'i ndëshkonte ata sipas ligjit penal.

44. Në analizë të sa më sipër, Gjykata çmon se për shkak të mangësive të veprimeve hetimore në kuptim të përshtatshmërisë, shpejtësisë dhe kujdesit të nevojshëm, autorët e veprës penale, përfshirë edhe atë të identifikuar, mundën t'i shmangeshin drejtësisë. Po ashtu, mosidentifikimi dhe mosmarrja në kohë e të gjitha provave të nevojshme për zbardhjen e ngjarjes, ka çuar në kufizimin më pas të mundësive për zbulimin e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe të autorëve të saj. Për më tepër, ndonëse prokuroria dispononte disa të dhëna rreth personave të mundshëm të përfshirë në krim dhe për motivet e tij, ajo nuk rezulton të ketë ndjekur një linjë të qartë hetimi. Nëse veprimet hetimore do të kishin qenë të shpejta, të plota dhe të orientuara drejt, nisur nga kjo gjasë, rezultati i hetimit do të kishte qenë i ndryshëm, duke shmangur në këtë mënyrë situatën e pandëshkueshmërisë së autorëve të atyre ngjarjeve kriminale. Ndodhur para këtyre fakteve, Gjykata vlerëson se prokuroria nuk ka qenë e kujdesshme në kryerjen e një hetimi të plotë, të shpejtë dhe të gjithanshëm, në mënyrë që të siguronte zbatimin efektiv të ligjit për të siguruar mbrojtjen e së drejtës së jetës. Ajo nuk ka përmblusur detyrimet e saj për të ndërmarrë në kohë veprime aktive dhe shteruese për zbulimin dhe ndëshkimin e autorëve të dyshuar të një ngjarjeje të rëndë kriminale, e cila përfshinte dy krime serioze,



atë të rrëmbimit dhe të vrasjes. Nga ana e saj mungojnë arsyet bindëse që të mund të justifikojnë dështimin për zbardhjen e ngjarjes, identifikimin e autorëve e dërgimin e tyre para gjykatës. Për më tepër, pezullimi i hetimit për zbulimin e autorëve për një periudhë të gjatë kohore (më shumë se 20 vjet) nuk ka ofruar ndonjë përgjigje efektive në këtë drejtim. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret evidentohet mungesa e një përgjigjeje efektive nga organi i ndjekjes penale për identifikimin, kapjen dhe ndëshkimin e personave përgjegjës për kryerjen e veprave penale, çka është thelbësore në ruajtjen e besimit të publikut, respektimin e shtetit të së drejtës dhe parandalimin e akteve të paligjshme. Nisur nga kjo, pretendimi i kërkuësës për cenimin e së drejtës së jetës për shkak të mungesës së hetimeve të plota dhe efektive nga organi i ndjekjes penale çmohet i bazuar.

45. Për sa u përket gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, Gjykata në kontekstin e rrethanave specifike të rastit (*shih paragrafët 25 dhe 26 të vendimit*) vlerëson se ato nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve lidhur me efektivitetin e hetimeve në këtë proces penal, por janë mjaftuar me konstatimin e faktit të parashkrimit që ndalonte vijimin e ndjekjes penale. Duke vepruar në këtë mënyrë, ato nuk kanë respektuar parimin e subsidiaritetit, pra nuk kanë përmbushur funksionin kushtetues për të garantuar dhe mbrojtur të drejtën themelore të jetës.

46. Nga sa më lart, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë rolin subsidiar në kontrollin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe duke pasur parasysh pamundësinë e vijimit të hetimit të çështjes për shkak të verifikimit të një kriteri ligjor pengues siç është ai i parashkrimit të ndjekjes penale, çmon se nuk ka vend për shfuqizimin e vendimeve të kundërshtuara. Ndaj, në këtë situatë, ajo do të shprehët vetëm për konstatimin e shkeljes së të drejtës së jetës, të garantuar nga neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së, në aspektin procedural, për shkak të mungesës së hetimeve të plota dhe efektive në zbulimin dhe ndëshkimin e autorëve të veprave penale objekt gjykimi.

47. Në përfundim, Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuësës Lumturi Varfi, sipas arsyetimit të mësipërm, është pjesërisht i bazuar, ndaj dhe kërkesa duhet të pranohet për një pjesë të saj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese të jetës për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore për kryerjen e hetimeve të plota dhe efektive.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 29.5.2024.

Shpallur, më 3.7.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim

VENDIM

Nr. 43, datë 4.6.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 4.6.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 15 (B) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:



KËRKUES: Bardhyl Ibra

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Ministria e Drejtësisë, përfaqësuar me autorizim nga Xhelal Kasaj, Erion Ndreca dhe Ornela Marku. Ministria e Financave

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-3346, datë 26.7.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave të gjykimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pikat 1 e 2 dhe 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 48 i ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*); nenet 396/6, 399/2, 399/4, 399/5 dhe 399/7 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim parashtimet me shkrim të kërkesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Ministrisë së Drejtësisë (*MD*) dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (*MFE*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesi Bardhyl Ibra (*kërkesi*) më datë 13.7.2017 ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (*Prokuroria Durrës*) ndaj punonjësve të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës (*ZVRPP, Durrës*). Në lidhje me këtë kallëzim, me vendimin nr. 3911, datë 26.12.2017, ajo prokurori ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ndaj këtij vendimi kërkesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila, me vendim të formës së prerë nr. 11-2018-1119(93),

datë 9.3.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe urdhëruar Prokurorinë Durrës të kryejë arsyetimin e plotë të vendimit të mosfillimit të çështjes penale, duke korrigjuar edhe gabimet materiale të këtij vendimi.

2. Më datë 28.5.2018, kërkesi ka depozituar padi në gjykatë kundër MD-së dhe MFE-së, duke kërkuar detyrimin e të paditurve për ta dëmshpërblyer në shumën 100.000 lekë, për shkak të veprimeve të parregullta të Prokurorisë Durrës në përmbushjen e detyrës, për shkak të mosarsyetimit të drejtë të vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. 3911/2017. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2019-4385)1993, datë 25.7.2019, ka vendosur pranimin e padisë, duke detyruar të paditurit, MD-në dhe MFE-në, t'i paguajnë kërkesit në mënyrë solidarë shumën prej 100.000 lekësh. Kundër këtij vendimi të paditurit kanë paraqitur ankim dhe çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit Durrës më datë 14.10.2019. Në vijim, pas organizimit të ri gjyqësor dhe fillimit të funksionimit të një gjykate të vetme apeli të juridiksionit të përgjithshëm, prej shkurtit 2023 çështja është për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

3. Më datë 29.5.2023, kërkesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të procesit të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit brenda afatit të arsyeshëm të ankimit të ushtruar nga të paditurit dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi ka kërkuar mendim nga gjyqtari relator i çështjes në gjykatën e apelit, me vendimin nr. 00-2023-3346, datë 26.7.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkesit. Kolegji Civil, në vlerësim të standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) për afatin e arsyeshëm, ka vlerësuar se çështja nuk paraqitet komplekse dhe nuk konstatohet ndonjë sjellje e palëve që të ketë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit. Në vijim, ai kolegji ka vlerësuar se për kërkesin nuk vjen ndonjë rrezik i veçantë nga mosgjykimi i çështjes në afatin e përcaktuar ligjor. Ndërsa për mosveprimin e gjykatës së apelit, Kolegji Civil ka vlerësuar se duhet mbajtur në konsideratë se vonesa e gjatë në shqyrtimin e çështjes është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që e kalon rastin konkret. Sipas tij, përbën një fakt të njohur botërisht



se reforma në drejtësi ka shkarkuar/pezulluar një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh, proces i cili natyrshëm ka sjellë kosto për qytetarët (*shih paragrafët 11, 13 dhe 14 të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

5. Më datë 14.11.2023, kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit. Kolegji i Gjykatës, më datë 27.12.2023, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

6. Gjykata, duke pasur në vëmendje se Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 31, datë 17.1.2024, “Për përvaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave”, i ka kaluar MF-së kompetencat e MFE-së, emrat ose akronimet e këtyre institucioneve në tekstin e këtij vendimi janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës që janë kryer veprime prej tyre.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1 *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi shqyrtimi i çështjes në gjykatën e apelit është regjistruar në vitin 2019 dhe ende nuk është shqyrtuar, në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Civile (KPC), nenet 399/1-399/12. Kjo zvarritje sjell pasoja negative për kërkuenin, pasi ai është në moshën 72-vjeçare, për rrjedhojë nuk ka kur ta gëzojë këtë të drejtë.

8. *Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se:*

8.1 Për sa i përket mosshqyrtimit të çështjes së kërkuetit duhet mbajtur në konsideratë ngarkesa totale individuale e gjyqtarit relator. Vonesa e gjatë në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve është një fakt i ditur botërisht si pasojë e reformës në drejtësi, e cila ka shkarkuar/pezulluar një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh. Gjykata ka trajtuar një sërë rastesh në lidhje me konstatimin e afatit të arsyeshëm, në të cilat ka analizuar ngarkesën e gjykatave dhe numrin e çështjeve të prapambetura. Gjithashtu, edhe Komisioni i Venecies e ka cilësuar reformën në drejtësi të domosdoshme edhe nëse do

të sillte pasoja të paparashikuara. Pala kërkuuese ka depozituar edhe herë të tjera kërkesa për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm në Gjykatën e Lartë dhe në 4 prej tyre është vendosur rrëzimi i tyre. Po kështu, në Gjykatë rezultojnë 3 kërkesa nga kërkuesi dhe në referim të tyre dilet në konkluzionin që kërkesat e tij më shumë se për t'i dhënë zgjidhje themelit të çështjeve të tij, janë tregues se ai po përdor mekanizma ligjorë për përfitime, duke krijuar në këtë mënyrë praktika abuzive.

9. *Subjekti i interesuar, Ministria e Financave, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se:*

9.1 Nga kërkesa e depozituar pala kërkuuese nuk paraqet kërtime të mirëfillta, por u referohet disa paragrafëve të vendimeve të Gjykatës dhe GJEDNJ-së ndër vite pa krijuar një renditje dhe lidhje logjike ndërmjet tyre. Gjykata duhet të investohet kur kërkuesi të ketë paraqitur një mjet procedural (*kërkesë*) që në brendësi parashtron argumente në lidhje me të drejtat me natyrë kushtetuese që i cenohen. Në rastin konkret ai nuk paraqet asnjë argument me natyrë kushtetuese lidhur me shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm. Nga ana tjetër, ligjvënësi, nëpërmjet ndryshimeve të KPC-së me ligjin nr. 38, datë 1.8.2017 (*ligji nr. 38/2017*), ka parashikuar rrethanat e pamundësisë objektive si kusht për mosllogaritjen e afateve që kalojnë, për sa kohë vepron kjo gjendje, që do të thotë se në kohëzgjatjen e gjykimit nuk llogaritet koha e pamundësisë objektive, duke përjashtuar zbatimin e nenit 399/2, pika 2, të KPC-së, nëse vlerësohet nga gjykata në të cilën po shqyrtohet çështja, se ndodhet në këto kushte.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi



gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor në gjykatën e apelit, për të cilin ka ngritur pretendime në drejtim të standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

12. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Për sa u përket kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata, pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike efektive që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individit duhet t’u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 44, datë 26.9.2023; nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata vëren se kërkuesi, bazuar në nenet 399/2 e vijues të KPC-së, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për përshpejtimin e gjykimit në apel të çështjes së tij, e cila ishte për shqyrtim në atë gjykatë që prej vitit 2019. Kolegji Civil, me vendimin nr. 00-2023-3346 datë, 26.7.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, ndaj, për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuesit për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual.

14. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, Gjykata vëren se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është i datës 26.7.2023, ndërsa komunikimi

i këtij vendimi i është bërë kërkuesit nëpërmjet shërbimit postar më datë 18.9.2023. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit, më datë 14.11.2023, ndaj në këto kushte Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuesit është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

15. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, në thelb, objekt i ankimit kushtetues individual është tejzgjatja e procedurave gjyqësore për shqyrtimin e çështjes së kërkuesit në gjykatën e apelit, i cili, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

16. Kërkuesi pretendon se i është cenuar e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, e garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, pasi shqyrtimi i çështjes në gjykatën e apelit është regjistruar në vitin 2019 dhe ende nuk është shqyrtuar në kundërshtim edhe me dispozitat e KPC-së, nenet 399/1–399/12. Kjo zvarritje sjell pasojat negative, pasi ai është në moshën 72-vjeçare, për rrjedhojë nuk ka kur ta gëzojë këtë të drejtë.

17. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka parashtruar se për mosshqyrtimin e çështjes së kërkuesit duhet mbajtur në konsideratë ngarkesa totale individuale e gjyqtarit relator. Vonesa e gjatë në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve është një fakt i ditur botërisht si pasojë e reformës në drejtësi e cila ka shkarkuar/pezulluar një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh. Gjykata ka trajtuar një sërë rastesh në lidhje me konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm në të cilat ka analizuar ngarkesën e gjykatave dhe numrin e çështjeve të prapambetura. Gjithashtu, edhe Komisioni i Venecias e ka cilësuar reformën në drejtësi të domosdoshme, edhe nëse do të sillte pasojat të paparashikuara. Pala kërkuese ka depozituar edhe herë të tjera kërkesa për cenimin e konstatimit të afatit të arsyeshëm në Gjykatën e Lartë dhe në 4 prej tyre është vendosur rrëzimi i padisë. Po kështu, në Gjykatë rezultojnë 3 kërkesa nga kërkuesi. Në referim të tyre dilet në konkluzionin që kërkesat e tij më shumë se për t’i dhënë zgjidhje themelit të çështjeve të tij janë tregues se ai po përdor mekanizma ligjorë për përfitime, duke krijuar në këtë mënyrë praktika abuzive.



18. Subjekti i interesuar, Ministria e Financave, ka parashtruar se kërkuesi nuk paraqet kërtime të mirëfillta por u referohet disa paragrafëve të vendimeve të Gjykatës dhe GJEDNJ-së ndër vite pa krijuar një renditje dhe lidhje logjike ndërmjet tyre. Gjykata duhet të investohet kur kërkuesi të ketë paraqitur një mjet procedural/kërkesë që në brendësi parashtron argumente në lidhje me të drejtat me natyrë kushtetuese që i cenohen. Në rastin konkret ai nuk paraqet asnjë argument me natyrë kushtetuese lidhur me shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshem. Nga ana tjetër, ligjvënësi nëpërmjet ligjit nr. 38/2017 ka parashikuar rrethanat e pamundësisë objektive si kusht për moslogaritjen e afateve që kalojnë për sa kohë vepron kjo gjendje, që do të thotë se në kohëzgjatjen e gjykimit nuk llogaritet koha e pamundësisë objektive, duke përjashtuar zbatimin e nenit 399/2, pika 2, të KPC-së, nëse vlerësohet nga gjykata se ndodhet në këto kushte.

19. Neni 42 i Kushtetutës përcakton se kushtdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshem. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi ka depozituar në gjykatën e rrethit padi me objekt dëmshpërblimin në vlerën 100.000 lekë për veprimet e parregullta të Prokurorisë Durrës në përmbushje të detyrës, për shkak të mosarsyetimit të drejtë të vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. 3911/2017 për kallëzimin e ushtruar nga ana e tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e ka pranuar padinë e kërkuetit, ndërsa të paditurit kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Durrës dhe çështja është regjistruar pranë saj më datë 14.10.2019. Sipas shkresës nr. 10713, datë 25.7.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, pas fillimit të

funksionimit të saj, çështja është rishortuar më datë 3.2.2023 dhe është në pritje për t'u shqyrtuar sipas radhës së çështjeve (nga më e vjetra) të të njëjtit lloj/natyre.

21. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjes civile, KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshem, ka përcaktuar afatin 2-vjeçar për përfundimin e gjykimit në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja "b", i KPC-së). Kjo nënkupton se formalisht gjykimi i çështjes në gjykatën e apelit ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

22. Në këtë drejtim, Gjykata, sikurse tashmë ka konstatuar gjatë gjykimit të çështjeve që lidhen me kohëzgjatjen e paarsyeshme të afatit në parim, vonesa në gjykimin e çështjeve të individëve është pasojë e ngarkesës së lartë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi. Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se pavarësisht rëndësisë dhe përfitimeve që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, kjo gjendje është duke u zgjatur prej disa vitesh, prandaj edhe metodat e identifikuar nga vetë gjykatat dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, në cilësinë e organit kushtetues që ka përgjegjësinë për të siguruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës), tregojnë se mekanizmat e parashikuar nga nenet 399/1-399/12 të KPC-së i shërbejnë një kohe normale të veprimtarisë gjyqësore, pra jo situatës së jashtëzakonshme, në pikëpamje të volumit, që ndodhet tashmë sistemi i drejtësisë (*shih vendimet nr. 61, datë 20.11.2023; nr. 68, datë 7.12.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në vështrim të standardeve të mësipërme, për të vlerësuar nëse në rastin në shqyrtim ka pasur tejzgjatje të paarsyeshme të afatit, pra nëse kërkuetit i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuetit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e



asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 68, datë 7.12.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në lidhje me *sjelljen e kërkuesit* Gjykata vëren se kërkuesi, pasi ka konstatuar se nuk ishte planifikuar shqyrtimi i ankimit të palës së paditur në gjykatën e apelit, i është drejtuar fillimisht Gjykatës së Lartë me kërkesën e datës 29.5.2023 për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e shqyrtimit të çështjes, në përputhje me parashikimet e KPC-së. Kjo kërkesë në vijim është rrëzuar nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00-2023-3346, datë 26.7.2023.

25. Gjykata vëren se edhe Gjykata e Lartë ka vlerësuar se nuk konstatohet ndonjë sjellje e palëve që të ketë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit (*shih paragrafin 13 të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se nuk rezulton që palët në proces të jenë bërë shkak ose të kenë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes.

26. Për sa i takon *kompleksitetit të çështjes*, Gjykata vëren se çështja ka natyrë civile, me të paditur MD-në dhe MF-në dhe ka vetëm një kërkim, atë të dëmshpërblimit në masën 100.000 lekë si pasojë e veprimeve të parregullta të Prokurorisë Durrës në përmbushje të detyrës, për shkak të mosarsyetimit të drejtë të vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. 3911/2017, për kallëzimin e bërë nga kërkuesi. Në këtë çështje, gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin e padisë dhe nëpërmjet ankimit nga të paditurit është vënë në lëvizje gjykata e apelit. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se çështja nuk paraqitet komplekse.

27. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, duke mbajtur në konsideratë për sa është theksuar më sipër për situatën aktuale të ngarkesës së sistemit gjyqësor për shkak të reformës në drejtësi (*shih paragrafin 14 të vendimit të Gjykatës së Lartë*), Gjykata vëren se çështja e kërkuesit është në pritje për shqyrtim në gjykatën e apelit tashmë prej më shumë se 4 vjetësh, ndërsa kohëzgjatja totale e procedurave nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatën e rrethit është mbi 5 vjet. Nga të dhënat e marra nga gjykata e apelit, sikurse arsyeton edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin për rrëzimin e kërkesës së tij për konstatimin e tejzgjatjes së gjykimit dhe përsheptimin e procedurave, ajo gjykatë është në pamundësi objektive për të gjykuar çështjen e kërkuesit brenda afatit të arsyeshëm, për shkak të volumit të lartë dhe radhës së çështjeve të

tjera më të vjetra, me të njëjtën shkallë ose më të lartë përparësie, në pritje për t'u gjykuar. Prandaj, në analizë të të dhënave të mësipërme, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkuesit lidhet me ngarkesën e lartë në gjykatën e apelit, shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi.

28. Së fundmi, në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi*, Gjykata, në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së, ka vlerësuar se për disa çështje ka interes veçanërisht të lartë nisur nga interesi i kërkuesit. Gjykata, referuar dokumenteve në dosjen gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, vëren se në thelb kërkuesi e ka lidhur të drejtën e tij për dëmshpërblim me veprimet e parregullta të prokurorisë për mosarsyetimin e drejtë të vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. 3911/2017 për kallëzimin e bërë nga ai. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se çështja e tij, për shkak të natyrës që ka, nuk lidhet me interesa “*vetjakë e jetësorë*”, duke qenë se pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me veprimet e parregullta të Prokurorisë Durrës, pretendime të cilat janë gjetur të drejta me vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. 11-2018-1119(93), datë 9.3.2018, e cila ka urdhëruar Prokurorinë Durrës të kryejë arsyetimin e plotë të vendimit të mosfillimit të çështjes penale, duke korrigjuar edhe gabimet materiale të këtij vendimi. Në këto kushte, në drejtim të kriterit të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesi për shkak të vonesës së gjykatës së apelit në shqyrtimin e çështjes së tij, Gjykata vlerëson se në kontekst të rrethanave të rastit, kërkuesi nuk ka argumentuar dhe provuar rrezikun për interesat e tij, natyra dhe rëndësia e të cilëve të justifikojë trajtimin me përparësi dhe shpejtësi të veçantë të çështjes së tij.

29. Për sa më sipër, duke vlerësuar së bashku përfundimet e analizës të secilit prej kriterëve të mësipërme që janë përcaktuese të kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, në kuptim të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesi, Gjykata çmon se në rrethanat e rastit konkret, për shkak të natyrës së çështjes dhe efekteve që ajo ka në gjykimin civil ku kërkuesi është palë, kjo çështje nuk përbën shkak të arsyeshëm në aspektin kushtetues për t'u shqyrtuar me prioritet, ndaj kërkesa nuk pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja



“i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 4.6.2024.

Shpallur, më 5.7.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Elsa Toska, Ilir Toska, Sandër Beci, Genti Ibrahim

Anëtar kundër: Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Marjana Semini

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes, që i përket kërkuarit Bardhyl Ibra, me objekt: “*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-3346, datë 26.7.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave të gjyqësorës*”, ne, gjyqtarët në pakicë, ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica, pasi vlerësojmë se duhet të ishte vendosur pranimi i kërkesës.

2. Në çështjen konkrete rezulton se kërkuari ka vënë në lëvizje një proces gjyqësor me objekt detyrimin e të paditurve, Ministria e Drejtësisë (MD) dhe Ministria e Financës dhe Ekonomisë (MF), për t’i shpërblyer dëmin në shumën 100.000 lekë për veprimet e parregullta të shkaktuara nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës për mosarsyetimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. 3911/2017, të kallëzuar prej tij, parregullsi e cila ishte vërtetuar me vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. 11-2018-1119(93), datë 9.3.2018. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2019-4385) 1993, datë 25.7.2019, ka vendosur pranimin e padisë. Mbi bazën e ankimit të subjekteve të interesuara, çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit Durrës më datë 14.10.2019. Duke qenë se çështja nuk u mor në shqyrtim nga gjykata e apelit për disa vite, më datë 29.5.2023 kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për

gjykimin e çështjes nga gjykata e apelit dhe përshpejtimin e procedurave, bazuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3346, datë, 26.7.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se vonesa e gjatë në shqyrtimin e çështjes është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që e kalon rastin konkret, që lidhet me efektet e reformës në drejtësi, si pasojë e së cilës janë shkarkuar/pezulluar një numër i konsiderueshëm gjyqtarësh (*shih paragrafët 11, 13 dhe 14 të vendimit të Kolegjit Civil*).

3. Më datë 14.11.2023, kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të çështjes nga gjykata e apelit dhe përshpejtimin e shqyrtimit të saj nga ajo gjykatë, konstatimin e cenimit të kësaj të drejte edhe nga Gjykata e Lartë, si edhe shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-3346 datë, 26.7.2023 të Kolegjit Civil të asaj gjykate.

4. Shumica, me të drejtë, e ka shqyrtuar çështjen sipas nenit 42 të Kushtetutës, duke konstatuar se është në pritje të një vendimi në gjykatën e apelit prej më shumë se 4 vjetësh, ndërsa kohëzgjatja totale e procedurave nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatën e rrethit është mbi 5 vjet. Në këto rrethana, për të përcaktuar nëse i është cenuar e drejta kushtetuese, ajo ka marrë në analizë kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuarit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfare rrezikon kërkuari. Shumica ka vlerësuar se kërkuari ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale (*shih paragrafin 25 të vendimit*), se çështja nuk paraqitet komplekse (*shih paragrafin 26*) dhe se kohëzgjatja e gjyqësorit të çështjes së kërkuarit lidhet me ngarkesën e lartë në gjykatën e apelit, shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi (*shih paragrafin 27*).

5. Ndërsa bashkohemi me shumicën në lidhje me këto gjetje, ndajmë qëndrim të ndryshëm për sa i përket vlerësimit të kriterit të “rëndësisë së asaj çfare rrezikon kërkuari”, pra pasojës që i shkaktohet atij nga tejzgjatja e procedurave gjyqësore. Për këtë kriter shumica ka vlerësuar se pretendimet e kërkuarit, në thelb, lidhen me të drejtën e tij për dëmshpërblim sipas parashikimeve të KPC-së, prej MD-së dhe MF-së, për shkak të sjelljes së prokurorisë për mosarsyetimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal të kallëzuar nga kërkuari. Prandaj,



sipas shumicës, e drejta për dëmshpërblim nuk lidhet me interesa “vetjakë e jetësorë”, duke qenë se të drejtën për arsyetimin e plotë të vendimit të prokurorisë kërkuesi e ka fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka urdhëruar prokurorinë të kryejë arsyetimin e plotë të vendimit. Ndaj, shumica ka vlerësuar se dëmshpërblimi në vlerën 100.000 lekë, në kushtet kur gjykata e apelit është e mbingarkuar, nuk është çështje e cila duhet të ketë përparësi në radhën e shqyrtimit të çështjeve nga gjykata e apelit (*shih paragrafin 29 të vendimit*).

6. Në vlerësimin tonë, ashtu siç ka pohuar edhe Gjykata, disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshejtim të posaçëm të gjykimit. Në këto raste duhet të merret parasysh rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi në procesin gjyqësor, pra rëndësia që ka për të e drejta objekt gjykimi. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë” lipset të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe verifikimi i kriterit të interesit të kërkuesit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 35, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Mbi bazën e standardit të mësipërm vlerësojmë se në çështjen konkrete marrin rëndësi dy aspekte. Së pari, e drejta e shpërblimit të dëmit dhe masa e tij për një individ të moshës 72-vjeçare nuk mund të konsiderohet se nuk përbën interes vetjak të rëndësishëm të tillë që të nxirret përfundimi se nuk ka shkelje të së drejtës kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Së dyti, rrethanat konkrete të çështjes, pra “kompleksiteti i ulët i çështjes” në raport me “kohëzgjatjen e konsiderueshme prej pothuajse 5 vjetësh në gjykatën e apelit”, nuk justifikojnë përfundimin e shumicës se nuk ka shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, sepse përndryshe e shndërron këtë të drejtë në iluzive dhe cenon besimin publik të sistemi i drejtësisë.

Në përfundim, bazuar në argumentet e përmendura më sipër, vlerësojmë se në rastin e kërkuesit Gjykata duhej të kishte vendosur pranimin e kërkesës.

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Sonila Bejtja

NJOFTIM

Nr. 10352/1, datë 8.7.2024

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maqedonisë së Veriut për krijimin e taks-forcave të përbashkëta në fushën e sigurisë, nënshkruar në Shkup, më 14.11.2022, ka hyrë në fuqi më 2 korrik 2024.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

URDHËR

Nr. 116, datë 8.7.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Bazuar në nenet 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; në nenin 13 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; në ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; në nenin 7 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar; si dhe në nenin 73 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për procedurat e prokurimit publik, të znj. Alba Qirjazi, Sekretar i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

2. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit.

3. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Sokol Çomo



VENDIM

Nr. 36, datë 3.7.2024

**PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI
NË RREGULLOREN “PËR
FUNKSIONIMIN E SISTEMIT
QENDROR TË REGJISTRIMIT DHE
SHLYERJES SË TITUJVE (AFISAR)”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISAR)”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 76, datë 18.12.2014, i ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Në nenin 50, pika 5/1, shkronja “a”, ndryshon sipas përmbajtjes: “*Operacionet e veçanta shlyhen në bazë mujore, në ditën e parë të muajit pasardhës*”.

2. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me botimin e këtij vendimi përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

KËRKESË

Nr. 492/9, datë 5.7.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Sistemim i rrugës ‘Andrea Stathi’, Bashkia Korçë”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Korçë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “trual”, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Korçë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1 545 197 (një milion e pesëqind e dyzetë e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra



TABELA PARAPRAKE ME LISTËN EMËRORE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTI”
“PËRMIRËSIMI I SHITRESAVE RRUGORE, RRUGA ‘ANDREA STATHI’, BASHKIA KORÇË”

Numër rendor	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE											VLERA TOTALE (LEKË)	Shënime
	Emër	Atësi	Mbiemër	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Truall (m²)	Volum	Faqe	“TRUALL”				
												Sipërfaqja (m²)	Çmimi lekë/ m²	VLERA (m²)		
															A	B
1	Migena	Jorgji	Demirxhiu	Korçë	8564	7/292	Truall	915.00	915.00	17	226	181	8,537	1.545.197	1,545,197	Ka shënime te seksioni C- TË DREJTAT REALE. Mbi këtë pasuri ndodhet pasuria me nr. 7/1277-Nd vol.42 f.27 në pronësi të Z. Artan dhe Liu Zyfiu. Dhe një pjesë e saj është pjesë e parcelës ndërtimore të lejes së legalizimit. Nuk ka shënime seksioni D- KUFIZIMET E PRONËSISË. Ka shënime seksioni E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN. Pjesëtim vullnetar pjesa "B" 012602 më dt. 29.3.2021 e bërë rivlerësimi 9,150,000 lekë bashkëpronarët janë Alfred Hamzai 1/4 pjesë, Fatiko Hamzai 1/4 pjesë Migena Demirxhiu 1/4 pjesë, Jolanda Hamzai 1/4 pjesë. 018048. Regj. prokurë për tërheqje Ç.P. nga Viollanda Sutikno; Fatiko Hamzai; Alfred Hamzai për Migena Demirxhiu 018198 korrigjim harte me urdhër të brendshëm.
	Viollanda	Enver	Sutikno													
	Fatiko	Enver	Hamzai													
	Alfred	Enver	Hamzai													
TOTALI														1,545,197		

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë

